



**VENDIM**  
**Nr. 49 Datë 23.06.2010**

**PËR**  
**MOSFILLIMIN E PROÇEDURAVE PËR**  
**LICENSIMIN E SHOQËRISË “ANSARA KONCESION” SH.P.K**

Në mbështetje të neneve 8, pika 2 gërma “a”, nenit 9 dhe 13 pika 1, gërma “a”, të Ligjit nr.9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, nenit 4, pika 1, gërma “a”, dhe 10, pikat 1 dhe 3 të “Rregullores për Proçedurat e Liçensimit, Modifikimit, Transferimit të Plotë/Pjesshëm dhe Rinovimit të Liçensave”, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr.108, datë 09.09.2008, nenit 18, pika 1, gërma “a”, të Rregullave të Praktikës dhe Proçedurave të ERE-s, miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.21, date 18.03.2009, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 23.06.2010, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “ANSARA KONCESION” sh.p.k, si dhe relacionin e Drejtorisë së Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi liçensimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike, të kësaj shoqërie,

**Konstatohet se:**

Aplikimi plotëson kërkesat e ERE-s lidhur me liçensimet në sektorin e energjisë elektrike të:

- **Formatin e aplikimit (neni 9, pika 1)** është plotësuar tërësisht.
- **Dokumentacionit juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2)** është plotësuar tërësisht.

Në formatin e aplikimit në pjesën e të dhënave teknike konstatohet mospërputhje në të dhënat mbi fuqinë e instaluar të centralit e cila nuk përputhet me atë të parashikuar në Kontratën e Konçesionit, çka devijon objektin e aplikimit sipas Kontratës së Konçesionit dhe ben te pamundur konsiderimin e tij nga ana e ERE-s.

Mungesa e Dokumentacionit sipas Rregullores së Proçedurave të Liçensimit, Modifikimit, Transferimit të Plotë/ të Pjesshëm dhe Rinovimit të Liçensave ka të bëjë me:

- **Pagesa e Rregjistrimit** të aplikimit nuk është bërë (neni 8, pika 2)
- **Mosdorezimi i aplikimit ne 2 kopje** siç përcaktohet në nenin 8 pika 6.

- Dokumentacionin financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, gërmat “b”, “c” dhe “d”) nuk janë plotësuar.
- Dokumentacionit teknik (neni 9, pikat 4) mungon Studimi i Fisibilitetit, (*është paraqitur vetëm studimi i rregjimit ujqor të burimeve që furnizojnë HEC si dhe raporti i vlersimit të ndikimit në mjedis*)
  - o Plani i Biznesit (*dokumenti i cili është paraqitur si Plan Biznesi jep vetëm një parashikim të prodhimit të energjisë elektrike per 8 muaj pa specifikuar periudhen, parashikim te shpenzimeve*)
  - o Miratimi i OSSH-s per lidhjen e centraleve me sistemin elektroenergjetik mban dt.18.11.2009 eshte per nje fuqi te instaluar te HEC 75 kË dhe eshte leshuar nga Drejtoria e Zones Elbasan.
  - o Leja e perdorimit te ujit per te cilen aplikuesi ka deklaruar se eshte ne proces te realizimit te kesaj kerkese
  - o Leja mjedisore per te cilen aplikuesi ka deklaruar se eshte ne proces te realizimit te kesaj kerkese

Për gjithë sa më sipër Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

#### **Vendosi:**

1. Mosfillimin e procedurave për licensimin e shoqërisë “ANSARA KONCESION” sh.p.k në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike.
2. Ngarkohet Drejtoria e Licensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI I ERE-S  
BUJAR NEPRAVISHTA**

